



REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		27. 02 2024	
Nj. Org.	Numë	Shtojca	Vlera
01	400/01	9419	

Republika e Kosovës / Republic of Kosovo

Komuna Drenas / Municipality Drenas

Zyra e Kryetarit



Komuna e Drenasit, në kuadër të zhvillimit të bujqësisë, bazuar në nenin 19 , pika 1.3 të Rregullores Nr.12-320-19338 të dt. 07.04.2017 për kushtet , kriteret dhe procedurat e ndarjës së subvencioneve, Rregullores për ndryshim dhe plotësim të rregullorës për ndarjën e subvencioneve me Nr.02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 si dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Worldwide- Zyra në Kosovë dhe Komuna e Drenasit me Nr. 01-400/01-7622 të dt 13.02.2024, njofton të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojn për projektet e poshtëshënuara:

THIRRJE PËR APLIKIM

1. Furnizim me Motokultivatorë
2. Furnizim me Sperkatëse 400L
3. Furnizim me Shpërndarëse të plehut artificial
4. Furnizim me Sera 100m²

➤ **Kriterët që duhët plotësuar për aplikim:**

1. Fermeri duhët të jetë banorë i Komunës së Drenasit;
2. Të posedoj tokë të punueshme:
 - Nëse aplikon në projektin për **Motokultivatorë** duhët të ketë se paku 0.10ha tokë të mbjellur me pemë ose 0.05ha me perime;
 - Nëse aplikon për **Spërkatëse 400L dhe Shpërndarëse të plehut artificial** duhët të ketë së paku 3ha të mbjellur me kultura pranverore ose vjeshtore (kjo dëshmohet me plotësim të aplikacionit nga aplikuesi dhe vertetohet me raportet që i posedon drejtoria nga aplikimet për Pagesa Direkte nga vitet 2022 dhe 2023);
 - Nëse aplikon për **Serë** duhët të ketë tokë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për vendosjen e serës si dhe ujë të mjaftueshem për ujitje;
3. Të posedoj traktor (vlenë për ata që aplikojnë për Spërkatëse 400L dhe Shpërndarëse të plehut artificial);
4. Të jetë i gatshëm për participim prej 30% të vlerës së asetit që përfiton;
5. Në bazë të rregullorës Nr.12-320-19338 të dt. 07.04.2017 neni 19, pika 2, rregullorës për ndryshim dhe plotësim për ndarjën e subvencioneve me nr. 02-400/01-18380 të dt.27.04.2022 neni 17 - Përparësi në kushte të barabarta kanë:

- ❖ Fermerët që nuk janë përfitues në tre vitet e fundit nga DBPZHR-ja;
- ❖ Fermerët që nuk janë përfitues nga MBPZHR-ja dhe Donatorë të tjerë brenda vitit fiskal;
- ❖ Të rinjët;
- ❖ Gjinia femrore;
- ❖ Familjët që kanë persona me nevoja të veçanta, familjët e dëshmorëve, familjët që kanë persona të zhdukur gjatë luftës, invalidët e luftës, veteranët e luftës, viktimat civile të luftës, familjet që kanë jetima;
- ❖ Përsonat me gjëndje të rënd ekonomike;
- ❖ Fermerët të cilët jetojnë në zona malore;
- ❖ Fermerët që janë të regjistruar para thirrjes publike.

➤ **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Aplikacioni i plotësuar;
2. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
3. Numri identifikues i fermerit (NIF);
4. Deklaratë për participim nga fermeri;
5. Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë;
6. Fleta poseduese e tokës që posedon (në emër të aplikuesit ose familjarit të ngushtë e dëshmuar me vijën e gjakut);
7. Fleta poseduese e tokës e marrur me qera (në emër të qiradhënësit apo e familjarit të ngushtë e dëshmuar me vijën e gjakut);
8. Kontratë e lidhur mes dy palëve për tokën e marrur me qera (të jetë së paku dy vjeçare)
9. Foton e traktorit që e posedon si dhe foton e numrit të motorit (vlenë për ata që aplikojnë për Spërkatëse 400L dhe Shpërndarëse të plehut artificial);
10. Dëshmi që posedon për përparsitë të cituara në piken nr.5 të thirrjes publike.

Verejtje: FERMERËT KANË TË DREJTË APLIKIMI VETEM NË NJËRËN NGA PROJEKTET E LARTËCEKUTA!

Afati i aplikimit nga data 27.02.2024-18.03.2024

Drenas 2024

Kryetari i Komunës



Ramiz Lladrovi